

RAPORT VJETOR PËR KRIMIN NGA URREJTJA

PËR VITIN
2023

**KRIME NGA
URREJTJA**



Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

Botues:

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut i përfaqësuar nga kryetarja prof. dr. Neda Zdraveva

Redaktor:

Urani Pirovska

Autor:

Natasha Petkovska

Përktheu dhe Lektura:

Eurolingua

Dizajni grafi:

Polyesterday

Shtypja:

Polyesterday

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје



**KOMITETI I
HELSINKIT PËR
TË DREJTAT E
NJERIUT**

ул. Наум Наумовски Борче 83
1000, Скопје
тел: +389 (0)2 3119 073
факс: +389 (0)2 3290 469
веб: www.mhc.org.mk
е-пошта: helkom@mhc.org.mk

PËRMBAJTJA

1. RRETH PROJEKTIT.....	5
2. METODOLOGJIA	6
2.1. Mësimi nga përvojat dhe të dhënat e kaluara	7
2.2. Mbajtja e ueb faqes interaktive për raportimin e krimeve nga urrejtja	7
2.3. Bashkëpunimi me dy rrjete joformale për monitorimin dhe regjistrimin e krimeve nga urrejtja që synojnë grupe specifike të synuara.....	7
2.4. Monitorimi i mediave kombëtare të shkruara dhe elektronike	7
2.5. Raportimi dhe verifikimi i krimeve/incidenteve të urrejtjes me Misionin e OSBE-së në Shkup.....	8
3. PËRMBLEDHJE E KONSTATIMEVE KRYESORE	9
Konteksti.....	9
3.1. Numri i incidenteve	10
3.2. Llojet e veprave penale	12
3.3. Incidentet sipas vendit	13
3.4. Incidente sipas muajit	13
3.5. Incidentet bazuar në motivim të njëanshëm.....	14
3.6. Viktimat dhe autorët.....	14
3.7. Analiza e sistemit shtetëror për statistikat e krimit nga urrejtja në prokuroritë dhe gjykatat publike në vend	15
4. AKTIVITETET E EKIPIT TË PROJEKTIT	18
4.1. Ofrimi i ndihmës juridike për viktimat e incidenteve të urrejtjes dhe monitorimi i gjykimeve për raste të caktuara të krimeve të urrejtjes të kryera në baza të ndryshme të mbrojtura.....	18
4.2. Monitorimi dhe raportimi i krimeve dhe incidenteve nga urrejtja, me vëmendje të veçantë ndaj dhunës politike, sportive, bashkëmoshatare dhe dhunës së kryer me motivim të njëanshëm midis të rinjve.....	19
4.3. Përpilimi dhe publikimi i buletineve mujore mbi situatën e krimeve të urrejtjes në vend bazuar në të dhënat e grumbulluara dhe të analizuara nga puna e Komitetit të Helsinkit dhe dy rrjeteve – Rrjetit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Rrjetit Kombëtar kundër Homofobisë dhe Transfobisë.....	20
4.4. Përgatitja, përkthimi dhe lëshimi i raportit të monitorimit në vitin 2022 në gjuhën maqedonase, shqip dhe anglisht	20
4.5. Analiza e sistemit shtetëror për statistikat e krimit nga urrejtja në prokuroritë dhe gjykatat publike në vend.....	21
4.6. Festimi i Ditës Botërore të Diversitetit Kulturor me organizimin e veprimtarisë “Turlitava 7”	21
5. KONKLUZIONE	24
6. REKOMANDIME	26

SHTOJCË INCIDENTE TË REGJISTRUARA NGA URREJTJA PËR VITIN 202327

1. Incident nga urrejtja midis të miturve në Parkun e Qytetit në Shkup.....	27
2. Incident nga urrejtja midis të miturve.....	27
3. Incidenti në ndeshjen e futbollit midis “Vardarit” nga Brvenica dhe “Besës” nga Çellopeku	28
4. Incidenti midis QKV “Borec” nga Velesi dhe KV “Shkëndija” nga Tetova	28
5. U dëmtua pllaka përkujtimore e një kompleksi përkujtimor që përkujton dëshmorët martirë shqiptarë në Sopot, rajoni i Kumanovës	29
6. Incident nga urrejtja ndërmjet të miturve në shkollë fillore në Çair.....	30
7. Incident nga urrejtja për shkak të përkatësisë etnike	30
8. Incident ndërmjet të miturve jashtë një qendre tregtare në Aerodrom	31
9. Sulmohet mbrojtësi i një institucioni publik për kujdes të fëmijëve	31
10. Incident në transportin publik në Shkup.....	32
11. Një i mitur u sulmua fizikisht në Karposh.....	32
12. I mitur u sulmua fizikisht në Gazi Babë	33
13. Disa të mitur sulmuan një të mitur në Gjorçe Petrov.....	33
14. Një grup të miturish sulmuan fizikisht një të mitur	34
15. I mitur sulmon një tjetër të mitur në transportin e qytetit të Shkupit.....	34
16. Dëmtimi i automjetit për shkak të përkatësisë politike	35
17. Dëmtimi i automjetit për shkak të përkatësisë politike.....	35
18. I mitur sulmohet në Kisella Vodë.....	36
19. Incident në autobus në zonën e Bit Pazarit	36
20. Incident në ndeshjen ndërmjet “Levskit” dhe “Shkupit”	37
21. Krim nga urrejtja në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës dhe origjinës etnike.....	37
22. Krimi nga urrejtja në bazë të besimit fetar	38
23. Dëmtim i monumentit të mbrojtësit të vdekur në fshatin Indzhikovë.....	39
24. Incident në ndeshjen e futbollit në Gazi Babë.....	39
25. Incident në bazë të përkatësisë etnike	40
26. Sulmohet i mituri 17-vjeçar në Shkup.....	40
27. Incident nga urrejtja në Shuto Orizari	41
28. Sulm fizik ndaj një shtetasi të Republikës së Turqisë.....	41
29. Incidenti nga urrejtja në bazë të besimit fetar dhe aftësisë së kufizuar.....	42
30. Krimi nga urrejtja në bazë të orientimit seksual	42
31. Incident në ndeshjen e futbollit ndërmjet “Shkupit” dhe “Vardarit”.....	43
32. Varri i dëmtuar në fshatin Paragushë	44
33. Incident në një autobus ndërmjet të miturve.....	44
34. I mitur sulmohet në Shuto Orizar	45
35. Incidenti nga urrejtja në bazë të besimit fetar	46

1. RRETH PROJEKTIT

Ky raport paraqet konstatimet që dalin nga aktivitetet e kryera nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në periudhën nga 1 prilli deri më 31 dhjetor 2023, me mbështetjen financiare të Misionit të OSBE-së në Shkup në kuadër të projektit “Mbështetje për Maqedoninë e Veriut në promovimin e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut III”. Ky raport shqyrton të dhënat për tërë vitin 2023, përkatësisht, duke filluar nga 1 janar deri më 31 dhjetor 2023. Qëllimi i projektit është të përmirësojë zbatimin e legjislacionit dhe reagimin e institucioneve në fushën e të drejtave të njeriut dhe anti-diskriminimit nëpërmjet ndryshimeve të politikave, zbatimit të mjeteve juridike efektive dhe forcimit të institucioneve. Një nga objektivat ishte dhe ende është përmirësimi i reagimit kombëtar ndaj krimeve dhe gjuhës së urrejtjes duke monitoruar, regjistruar dhe përpunuar krimet nga urrejtja në përputhje me kuadrin legjislativ të ndryshuar. Pritet që aktivitete të tilla të rrisin ndërgjegjësimin për efektet e dëmshme të gjuhës së urrejtjes dhe intolerancës.

Hapi i parë drejt sigurimit të një sistemi efektiv për mbrojtjen e viktimave të krimeve nga urrejtja është ngritja e kapaciteteve të organeve të drejtësisë penale në fushën e regjistrimit të incidenteve të njëanshme. Në mënyrë të veçantë, qëllimi i raportit është të përdoret si një tregues për vëllimin, natyrën dhe shpeshtësinë e incidenteve të krimeve të urrejtjes të kryera në vend.

Në kuadër të mandatit si partner në zbatimin e aktiviteteve në suazat e projektit, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut gjatë vitit 2023 zbatoi aktivitetet e mëposhtme:

- 1.1.** Ofrimi i ndihmës juridike për viktimat e incidenteve të urrejtjes dhe monitorimi i gjykimeve për raste të caktuara të krimeve të urrejtjes të kryera në baza të ndryshme të mbrojtura;
- 1.2.** Mirëmbajtja, përditësimi dhe promovimi i faqes së internetit www.zlostorstvaodomraza.com në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze;
- 1.3.** Monitorimi dhe regjistrimi i krimeve dhe incidenteve nga urrejtja;
- 1.4.** Përpilimi dhe publikimi i buletineve mujore mbi situatën e krimeve të urrejtjes në vend bazuar në të dhënat e grumbulluara dhe të analizuara nga puna e Komitetit të Helsinkit dhe dy rrjeteve – Rrjetit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Rrjetit Kombëtar kundër Homofobisë dhe Transfobisë;
- 1.5.** Përgatitja, përkthimi dhe lëshimi i raportit të monitorimit në vitin 2023 në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze;
 - 1.5.1.** Përgatitja, lëshimi, promovimi dhe shpërndarja e një infografiku që do të ofrojë një përmbledhje të shkurtër të të dhënave për krimet nga urrejtja të regjistruara në vitin 2023;
 - 1.5.2.** Pasqyrë e incidenteve të raportuara të krimeve nga urrejtja dhe kontributi në Raportin vjetor të ODIHR-së 2023 për krimet dhe incidentet nga urrejtja në rajonin e OSBE-së;
- 1.6.** Analiza e sistemit shtetëror për statistikat e krimit nga urrejtja në prokuroritë dhe gjykatat publike në vend
- 1.7.** Festimi i Ditës Botërore të Diversitetit Kulturor (19 maj) me organizimin e veprimtarisë “Turlitava 7”.

2. METODOLOGJIA

Në Maqedoninë e Veriut, si në nivel global, krimet nga urrejtja raportohen rrallë, duke supozuar se viktimat nuk besojnë se raportimet e tyre do të marrin një zgjidhje pozitive, ose nga frika e gjykimeve të gjata dhe shpenzimeve. Prandaj, çdo informacion i siguruar në lidhje me parandalimin është me rëndësi të madhe për të parë llojin më të zakonshëm të incidenteve, tendencat negative, vendet e ndodhjes dhe marrëdhëniet midis viktimave dhe autorëve. Është e nevojshme të theksohet se krimet nga urrejtja nuk janë një fenomen që prek vetëm komunitete të caktuara, përkundrazi, ato janë një sulm i drejtpërdrejtë ndaj shoqërisë demokratike dhe parimeve mbi të cilat bazohen të drejtat e njeriut.

Incidentet e krimeve nga urrejtja nuk ndodhin rastësisht, ato janë një manifestim i dhunshëm i ndarjeve, stereotipeve dhe paragjykitimeve. Duke synuar identitetin e një personi, krimet e urrejtjes shkaktojnë më shumë dëme dhe pasoja sesa veprat penale themelore. Viktima e drejtpërdrejtë e krimeve të urrejtjes, si dhe njerëzit në mjedisin e saj të ngushtë që i përkasin të njëjtit grup, pësojnë trauma të mëdha dhe ndjenja të shtuara të pasigurisë si rezultat i faktit se janë ata që zgjidhen për shkak të karakteristikave të caktuara të cilat nuk mund t'i ndryshojnë. Zgjidhja më e mirë për krimet nga urrejtja, në rastet kur ato kryhen, është fillimi i procedurave gjyqësore dhe sanksionimi. Me një njohje të tillë publike, viktimat mund të sigurohen se përvoja e vuajtur njihet plotësisht dhe në mënyrë të përshtatshme, gjë që rrit më tej besimin midis anëtarëve të tjerë të komunitetit se krimet e urrejtjes do të ndëshkohen¹.

“Krim nga urrejtja” në raport nënkupton një krim kundër një personi fizik ose juridik dhe me ta persona të lidhur ose pronë që është kryer tërësisht ose pjesërisht për shkak të një karakteristike reale ose të supozuar (të imagjinuar) ose lidhjes së një personi që ka të bëjë me racën, ngjyrën e lëkurës, kombësinë, origjinën etnike, fenë ose besimin, paaftësinë mendore ose fizike, seksin, identitetin gjinor, orientimin seksual dhe bindjen politike.² Çdokush mund të jetë viktimë e krimit nga urrejtja, megjithëse viktimat më të zakonshme janë anëtarët e komuniteteve të rrezikuara. Krimet nga urrejtja kryesisht synojnë anëtarët e bashkësive të ndryshme etnike, fetare ose të objekteve të shenjta, romët, pakicat seksuale dhe personat e zhvendosur brenda vendit.

Kështu, metodologjia për raportimin e krimeve nga urrejtja e aplikuar në raport përbëhet nga mësimi nga përvojat dhe të dhënat e kaluara, mbajtja e një faqe interneti interaktive për raportimin e krimeve nga urrejtja, monitorimi i mediave të shkruara dhe elektronike kombëtare, monitorimi i buletineve ditore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, bashkëpunimi me rrjetet joformale për monitorimin dhe regjistrimin e krimeve nga urrejtja që synojnë grupe të veçanta të synuara, dhe raportimi dhe kontrolli i dyfishtë i krimeve dhe incidenteve nga urrejtja me Misionin e OSBE-së në Shkup.

1 Šečić kundër Kroacisë, kërkesa nr. 40116/02 datë 31.08.2007, f. 66-70

2 Neni 122 paragrafi 42 i Kodit penal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/96, 80/99, 4/02, 43/03, 19/04, 81/05, 60/06, 73/06, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 41/14, 115/14, 132/14, 160/14, 199/14, 196/15, 226/15, 97/17 dhe 248/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nr.36/23).

2.1. Mësimi nga përvojat dhe të dhënat e kaluara

Për të zbatuar një qasje diagnostikuese drejt grumbullimit të krimeve nga urrejtja dhe sistemet e fuqishme të monitorimit, Komiteti i Helsinkit fillimisht mbështetet në përvojat e kaluara dhe zhvillon praktikën më të mirë nga të cilat zbatohen rezultatet. Nga ana tjetër, grumbullimi i të dhënave është hapi i parë drejt luftimit të krimeve nga urrejtja sepse informacioni dhe statistikat e besueshme janë të nevojshme për të zhvilluar politika të synuara dhe për të përshtatur mbështetjen për viktimat. Gjatë shkrimit të raportit u morën në konsideratë raportet mbi punën në këtë fushë për vitet e kaluara.³

2.2. Mbajtja e ueb faqes interaktive për raportimin e krimeve nga urrejtja

[Ueb portali](http://www.zlostorstvaodomraza.com) – www.zlostorstvaodomraza.com, i disponueshëm që nga viti 2013, është një mjet interaktiv për informimin e qytetarëve për krimet e kryera nga urrejtja dhe raportimin e incidenteve nga përdoruesit e tij. Përmban një hartë interaktive që tregon vendndodhjen e saktë ose të përafërt ku ka ndodhur incidenti. Faqja kryesore ofron kategori të krimeve nga urrejtja dhe motive të njëanshme, shfaqen informacione se si qytetarët mund të raportojnë incidentet, përmes një aplikacioni elektronik, formularëve të postës elektronike dhe internetit, si dhe grafikët statistikorë. Mund të gjenden gjithashtu tabela për pyetje të shpeshta, burime dhe fjalor në ueb portalin që publikojnë rregullisht informacione në lidhje me projektin, rëndësinë dhe fushëveprimin e krimeve nga urrejtja, si dhe publikime në lidhje me këtë fenomen. Të gjitha materialet janë në dispozicion në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze.

2.3. Bashkëpunimi me dy rrjete joformale për monitorimin dhe regjistrimin e krimeve nga urrejtja që synojnë grupe specifike të synuara

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka krijuar bashkëpunim në fushën e krimit nga urrejtja me të dy rrjetet joformale ku është anëtar – Rrjeti për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Rrjeti Kombëtar kundër Homofobisë dhe Transfobisë me qëllim të rritjes së fushës së monitorimit dhe regjistrimit të krimeve nga urrejtja që synojnë grupe specifike të synuara. Shtrirja e shtuar e monitorimit përmes të dy rrjeteve nënkuptonte gjithashtu qasje për viktimat e incidenteve të motivuara nga paragjykimi bazuar në orientimin seksual (të supozuar) dhe identitetin gjinor, të cilëve Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut u ofroi këshillim dhe mbështetje ligjore.

2.4. Monitorimi i mediave kombëtare të shkruara dhe elektronike

Komiteti i Helsinkit vazhdoi të monitorojë numrin e gazetave të përditshme me pikëpamje të ndryshme ideologjike dhe përkatësi politike në vitin 2023. Monitorimi elektronik i mediave bëhet çdo ditë, përmes dy gjeneratorëve më të njohur të lajmeve në internet (www.time.mk dhe www.grid.mk), si dhe duke përdorur opsionet e avancuara të kërkimit në seksionin “lajme” të www.google.com.

³ <https://zlostorstvaodomraza.com/izvestaj/>.

Qëllimi kryesor i monitorimit të medias është të identifikojë ndodhitë e mundshme të incidenteve nga urrejtja dhe të ftojë viktimat e pretenduara në një intervistë, si dhe t'u ofrojë atyre mundësinë e ndihmës juridike ose monitorimit të procesit gjyqësor për rastin e tyre.

2.5. Raportimi dhe verifikimi i krimeve/incidenteve të urrejtjes me Misionin e OSBE-së në Shkup

Detajet në lidhje me incidentet (çfarë ka ndodhur, data, koha, vendi, burimi i informacionit, viktimat e prekura, autorët, statusi i rastit, reagimi i autoriteteve lokale dhe ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin) u raportuan rregullisht në Misionin e OSBE-së në Shkup. Monitorimi i rasteve u lehtësua shumë nga funksionimi i vazhdueshëm i suksesshëm i ueb platformës për hartëzimin e krimeve nga urrejtja. Përveç mundësisë për të monitoruar incidentet në internet të krimeve nga urrejtja, pas shfaqjes së tyre, Misioni i OSBE-së në Shkup mori një raport përfundimtar të përkohshëm të përgatitur nga Komiteti i Helsinkit. Konstatimet u ndanë gjithashtu me OSBE/ODIHR në raportin e tyre vjetor për krimet nga urrejtja në shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së.

Duke zbatuar këto aktivitete, Komiteti i Helsinkit regjistroi 197 krime/incidente nga urrejtja për periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2023, një rritje prej 23% krahasuar me vitin 2022. 27 nga rastet e regjistruara kanë tregues të qartë të njëanshëm, ndërsa incidentet e tjera në përputhje me treguesit e tjerë (vendndodhja, mënyra e ekzekutimit, përfshirja e të miturve dhe nxënësve të shkollave të mesme, etj.) ekziston besim i arsyeshëm se janë kryer për shkak të përkatësisë etnike të viktimës, përkatësisht autorit të krimit.

Rezultatet paraqiten në një përmbledhje të konstatimeve kryesore, ndërsa në raport bashkëngjitet gjithashtu një shtojcë që detajon çdo incident të krimit nga urrejtja të botuar në faqen e [internetit www.zlostorstvaodomraza.com](http://internetit.www.zlostorstvaodomraza.com) në vitin 2023.

3. PËRMBLEDHJE E

KONSTATIMEVE KRYESORE

Konteksti

Komisioni Evropian (KE), për të pestin vit⁴ radhazi në Raportin e tij për Maqedoninë e Veriut në vitin 2023, vëren se disponueshmëria e të dhënave zyrtare për krimin nga urrejtja mbetet sporadike pavarësisht përpjekjeve të qeverisë për të zhvilluar një sistem për regjistrimin dhe grumbullimin e të dhënave. Për më tepër, Komisioni Evropian thekson nevojën për të bërë përpjekje për të rritur kapacitetet e organeve policore dhe gjyqësore për të parandaluar dhe ndjekur penalisht në mënyrë më efektive të gjitha rastet e dhunës, krimeve nga urrejtja dhe gjuhës së urrejtjes, si pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për të nxitur një kulturë më tolerante dhe jo-diskriminuese në shoqëri.⁵ KE gjithashtu vëren se Komiteti i Helsinkit është e vetmja organizatë e shoqërisë civile që vazhdon të grumbullojë dhe analizojë me sukses të dhënat për krimet nga urrejtja. KE përfundon se duhet të ketë një praktikë sistematike të grumbullimit të të dhënave dhe trajtimit të gjuhës së urrejtjes dhe krimin nga urrejtja.⁶

Konkluzioni i përgjithshëm është se njohja dhe regjistrimi adekuat dhe i përkohshëm i krimeve nga urrejtja nga nëpunësit policorë, autoritetet e prokurorisë dhe autoritetet gjyqësore mbetet i pakënaqshëm. Ministria e Punëve të Brendshme raportoi 52 incidente të paspecifikuara në vitin 2023 dhe dy incidente të sulmit fizik ndaj personave LGBTI në OSBE/ODIHR.⁷ Në raportin vjetor të Ministrisë për vitin 2023, seksioni për vepra penale nga urrejtja publikoi të dhëna për gjithsej 41 vepra penale që përmbajnë elemente të urrejtjes.⁸ Megjithatë, nga shqyrtimi i statistikave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, vërehet se 31 prej tyre janë vepra penale “Përhapja e materialit racist dhe ksenofobik përmes një sistemi kompjuterik”, 6 janë “Rrezikimi i sigurisë” përmes një sistemi informacioni”, 2 janë vepra penale “Nxitja e urrejtjes, mosmarrëveshjes ose intolerancës mbi baza kombëtare, racore, fetare dhe të tjera diskriminuese” dhe nga një prej tyre janë “dhunë” dhe “diskriminim racor dhe diskriminim i llojeve të tjera”.⁹ Statistikat e paraqitura tregojnë se Ministria e Punëve të Brendshme nuk bën ndarje të gjuhës së urrejtjes dhe krimin nga urrejtja.

Ky raport tregon me saktësi se të drejtat e kujt u shkelën më shumë në periudhën nga 01.01.2023 deri më 31.12.2023 në Maqedoninë e Veriut, si rezultat i incidenteve të motivuara nga paragjykimi

4 Komisioni Evropian, *Raporti për Maqedoninë e Veriut 2019*, Bruksel, 29 maj 2019, f. 20, 24, 30, 31., Komisioni Evropian, *Raport për Maqedoninë e Veriut 2020*, Bruksel, 6 tetor 2020, f. 32., Komisioni Evropian, *Raport për Maqedoninë e Veriut 2021*, Bruksel, 19 tetor 2021, f. 32., Komisioni Evropian, *Raport për Maqedoninë e Veriut 2023*, Bruksel, 12 tetor 2023, f. 32-35.

5 Komisioni Evropian, *Raport për Maqedoninë e Veriut për vitin 2023*, Bruksel, 8 nëntor 2023, f. 34.

6 Ibid, f.34.

7 Shih më shumë në: <http://hatecrime.osce.org/north-macedonia>.

8 Ministria e Punëve të Brendshme, Raporti vjetor 2023. Faq. 69. Në dispozicion në: https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/Godisen%20izvestaj/%D0%93%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%88%D0%B5%D0%BD%20%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98%202023.pdf

9 Ibid, f. 70.

dhe krimeve nga urrejtja. Raporti ofron një pasqyrë të numrit të incidenteve, llojit të krimeve, vendit dhe kohës së ndodhjes, karakteristikave të mbrojtura të viktimave (raca, ngjyra e lëkurës, kombësia, origjina etnike, feja ose besimi, paaftësia mendore ose fizike, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual dhe bindja politike) dhe të dhëna për autorët. Në fund, përfundimet tregojnë se ku janë të nevojshme ndërhyrje urgjente dhe efektive për të parandaluar dëmet në të ardhmen. Prandaj, raporti mund të jetë një mjet i dobishëm për vendimmarrësit që të ndër marrin hapa të mëtejshëm në luftën kundër krimit nga urrejtja.

3.1. Numri i incidenteve

Në vitin 2023, KHM regjistroi 197 incidente të mundshme të krimeve nga urrejtja, nga të cilat 35 ishin incidente me tregues të qartë të njëanshëm.¹⁰ Incidentet u regjistruan menjëherë pasi u publikuan nga mediat ose Ministria e Punëve të Brendshme në gazetatat e tyre të përditshme.

Për incidente të mundshme, Ministrisë së Punëve të Brendshme iu kërkua konfirmim për 151 incidente të mundshme në SPB Shkup, 14 incidente të mundshme në SPB Tetovë, tre incidente të mundshme në SP-ON Gostivar dhe një incident i mundshëm secili në SPB Kumanovë dhe në SPB Strumicë. Në përgjigjen e tij, SPB Shkup na dha të dhëna vetëm për parashtrimin e denoncimeve penale/kundërvajtëse dhe veprat penale/kundërvajtjet për incidente të mundshme, pa u përgjigjur nëse ka indikacione që tregojnë se incidentet kanë ndodhur për shkak të një karakteristike të caktuar të mbrojtur të personave të përfshirë në përputhje me nenin 122 paragrafin 42 të Kodit penal. Megjithatë, mund të theksohet nga përgjigja e marrë se për çdo rast në të cilin është paraqitur një kallëzim, vepra penale nuk cilësohet si krim nga urrejtja ose kundërvajtje. Në raportimin e tij, SPB Tetovë deklaroi në mënyrë të qartë se veprat penale të theksuara nuk janë kryer nga urrejtja, ndërsa SP-ON Gostivar paraqiti të dhëna nga të cilat vërehet se në rastet specifike nuk ka tregues të njëanshëm. SPB Kumanovë dhe SPB Strumicë nuk paraqitën përgjigje për kërkesat e paraqitura për informacion me karakter publik.


Për shumicën e incidenteve të mundshme të pakonfirmuara dhe krimeve nga urrejtja, dhe në përputhje me treguesit e tjerë (vendndodhja, mënyra e ekzekutimit, përfshirja e të miturve dhe nxënësve të shkollave të mesme, etj.), ekziston besim i arsyeshëm se janë kryer për shkak të përkatësisë etnike të viktimës përkatësisht kryerësit të krimit. Megjithatë, incidentet e mundshme të pakonfirmuara përfshihen në raport sepse lidhen me situata ku, sipas treguesve të tjerë, ekziston një bazë për të besuar se këto incidente janë të motivuara në mënyrë të njëanshme. Ndër këta tregues të njëanshëm janë:

- perceptimi i viktimës/dëshmitarit;
- komentimi në vendngjarje;
- dallimi midis viktimës dhe kryerësit në baza etnike;
- modeli/frekuenca e incidenteve të mëparshme;
- natyra e dhunës;

¹⁰ Incidentet me tregues të qartë të njëanshëm publikohen në faqen e internetit www.zlostorstvaodomraza.com.

- mungesa e motiveve të tjera; dhe
- vendi dhe koha.

Konkretisht, incidentet e mundshme përfshihen në këtë raport për shkak të informacionit të marrë për vendin e ngjarjes (shembull: vendbanimi ose shkolla të përziera etnikisht, linjat e autobusëve të përdorura nga anëtarët e bashkësive të ndryshme etnike, vendet ku kanë ndodhur krime nga urrejtja në të kaluarën), lloji (shembull: një grup më i madh i të miturve sulmojnë një ose më shumë viktime pa asnjë provokim, përplasje fizike në grup, sulmet në autobusë ose në stacionet e autobusëve), koha (shembull: sipas llogaritjeve të mëparshme si një formë hakmarrjeje, pas shkollës, gjatë ose pas një ndeshjeje sportive) dhe prona e dëmtuar gjatë incidentit (shembull: vendet e riteve fetare).



Baza etnike (179 incidente, 90.86%) përsëri zë pjesën më të madhe të bazave për krimet e kryera nga urrejtja në vitin 2023. Motivi në 2 incidente është bindja politike dhe përcaktimi politik, 6 incidente kanë ndodhur si rezultat i bindjeve fetare, 2 incidente janë motivuar nga orientimi seksual dhe 8 incidente kanë ndodhur bazuar në disa karakteristika të tjera të mbrojtura. Viktimat dhe autorët janë kryesisht të rinj dhe anëtarë të komuniteteve të ndryshme etnike, anëtarë të klubeve të tifozëve të ekipeve sportive ose mbështetës të partive politike. Shpesh ndodh që një incident të plotësojë kriteret për të dyshuar për ekzistimin e dy ose më shumë veprave penale, prandaj numri i veprave penale është më i madh se numri i incidenteve.

Shumica e veprave penale të pretenduara përfshijnë: dhunën (153), dëmtimin trupor dhe dëmtimin serioz (24), dëmtimin e pronës (7), grabitjen (2), shkatërrimin e simboleve (4), shkaktimin e urrejtjes kombëtare, racore, fetare, përçarjes dhe intolerancës (5), kërcënimin serioz (1), rrezikimin e sigurisë (3) dhe shkaktimin e rrezikut të përgjithshëm (2). Detajet e incidenteve, si përshkrimi i shkurtër, data, koha, vendi, burimi i informacionit, viktimat e prekura, autorët, statusi i rastit, reagimi i autoriteteve, ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin, gjenden në Aneksin e raportit me titull “Incidentet e krimeve nga urrejtja për vitin 2023”. Aneksi gjithashtu përmban një fushë për “tregues të njëanshëm”, të përfshirë në secilin incident individual. Kjo fushë rendit të dhëna për: perceptimin e viktimës/dëshmitarit, komentin në vend, dallimin ndërmjet viktimës dhe dhunuesit bazuar në përkatësinë etnike, modelin/shpeshësinë e incidenteve të mëparshme, natyrën e dhunës, mungesën e motiveve të tjera dhe vendin dhe kohën.

Në qershor 2023, KHM dërgoi Raportin vjetor të vitit 2023 për krimet nga urrejtja në OSBE/ODIHR¹¹ dhe është ende e vetmja organizatë joqeveritare që dërgon sistematikisht informacion në OSBE/ODIHR për situatën e krimeve nga urrejtja në vend.

Me vetëm 2 incidente të regjistruara të kryera në bazë të përkatësisë dhe bindjes politike, mund të thuhet se numri i incidenteve me paragjykimet politike vazhdon të ulet këtë vit, ndryshe nga vitet e mëparshme kur para dhe gjatë proceseve zgjedhore, numri i incidenteve të urrejtjes bazuar në përcaktimin politik u rrit ndjeshëm.¹²

Më e spikatura është tendenca e incidenteve që kanë ndodhur bazuar në prejardhjen e ndryshme etnike të dhunuesit dhe viktimës. Në vitin 2013, këto incidente përbënin 84% të incidenteve totale (98 nga 116), ndërsa në vitin 2014 kjo përqindje ishte 61% (53 nga 87). Në vitin 2015, vetëm 36% e incidenteve (16 nga 44) ndodhën ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve, në vitin 2016 përqindja ishte 49% e të gjitha incidenteve (34 nga 70), dhe në vitin 2017 – 29 incidente (41%). Në vitin 2018, numri i incidenteve të regjistruara të krimeve nga urrejtja bazuar në origjinën etnike u rrit përsëri në 64% (79 nga 123) të të gjitha incidenteve të regjistruara. Në vitin 2019, 85% e të gjitha incidenteve të regjistruara (135 nga 159), në vitin 2020 - 73% (76 nga 104) dhe në vitin 2021 – 36% (29 nga 80)¹³. Në vitin 2022, 83.75% (134 incidente) e numrit të përgjithshëm të incidenteve kanë ndodhur bazuar në prejardhjen e ndryshme etnike të dhunuesit dhe viktimës.¹⁴ Në vitin 2023, trendi i incidenteve në baza etnike vazhdon, dhe zë 90% (179 incidente) të numrit të përgjithshëm të rasteve të regjistruara (197). Incidentet kryesisht ndodhin ndërmjet anëtarëve të komuniteteve maqedonase dhe shqiptare.

3.2. Llojet e veprave penale

Shumica e incidenteve janë kryer nga të rinjtë, ndërsa shumë prej autorëve janë të panjohur. Viktimat dhe autorët e veprës penale zakonisht janë anëtarë të bashkësive të ndryshme etnike, ndërsa incidentet e raportuara lidhen me vepra penale të caktuara të Kodit penal: dhunë (153), dëmtim trupor dhe lëndim i rëndë (24), dëmtim i pronës (7), grabitje (2), shkatërrim i simboleve (4), shkaktim i urrejtjes kombëtare, racore, fetare, përçarjes dhe intolerancës

(5), kërcënim serioz (1), rrezikim i sigurisë (3) dhe shkaktim i rrezikut të përgjithshëm (2). Shumë shpesh një incident plotëson kriteret për dy ose më shumë vepra penale (shembull: dhunë dhe vjedhje), prandaj numri i veprave penale ndonjëherë është më i lartë se numri i incidenteve në të dhëna.¹⁵


11 Shih më shumë në: <http://hatecrime.osce.org/north-macedonia>.

12 Të gjitha incidentet e regjistruara mbi këtë bazë janë regjistruar në tetor 2021 gjatë zgjedhjeve lokale. Në shumicën e incidenteve të kryera si rezultat i vendosmërisë politike ose bindjes politike, viktimat nuk janë njerëz, por persona juridikë si rezultat i faktit se shumica e këtyre incidenteve kanë të bëjnë me dëmtimin e pronës dhe shkaktimin e dëmit material. Shiko më shumë <https://mhc.org.mk/reports/godishen-izvestaj-za-sostojbata-so-chovekovite-prava-vo-2021-godina/>.

13 Gjatë vitit 2021 janë regjistruar gjithsej 80 incidente, që është 20% më pak se në vitin 2020. Arsyeja për numrin e zvogëluar të incidenteve të regjistruara është se në vitin 2020, KHM kishte një qasje më kufizuese, dhe për shkak të mungesës së reagimeve nga MPB-ja në lidhje me krimet e mundshme nga urrejtja, regjistruam vetëm ato vepra penale për të cilat kishte tregues të qartë se ishin krime nga urrejtja, ndërsa për ato vepra për të cilat nuk ka tregues të mjaftueshëm, u vendos që të mos publikohen derisatë merren informacione nga Ministria e Punëve të Brendshme. Shiko më shumë në <https://mhc.org.mk/reports/godishen-izvestaj-za-sostojbata-so-chovekovite-prava-vo-2021-godina/>.

14 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (2023). Vjetari për krimin nga urrejtja 2023. Në dispozicion në: https://zlostorstvaodmraza.com/wp-content/uploads/2023/09/GODISEN-IZVESTAJ_ZLOSTORSTVA-OD-OMRAZA-2023_MK_ALB_ENG_PO653136_23.08.2023.pdf

15 Krimet nga urrejtja rregullohen nga Kodi penal, ndërsa incidentet mbulojnë një vëllim më të lartë të rasteve që përfshijnë vepra penale si grafitë nga urrejtja, thirrje nacionaliste e kështu me radhë.




Vepra penale

- dhunë
- lëndim trupor dhe lëndim i rëndë trupor
- dëmtim i pronës
- vjedhje
- shkatërrim i simboleve
- shkaktim i urrejtjes kombëtare, racore, fetare, përçarjes dhe intolerancës
- kërcënim serioz
- rrezikim i sigurisë

3.3. Incidentet sipas vendit

Shumica e incidenteve – 164 kanë ndodhur në Shkup dhe komunat përreth. Ka pasur 16 incidente në Tetovë, 3 incidente në Gostivar dhe Kumanovë, 2 në Manastir, 1 në Shtip, Veles, Strumicë, Kriva Pallankë dhe Prilep.


Shumica e qyteteve janë të vendosur në rajone të banuara nga një pakicë më e madhe etnike e shqiptarëve etnikë (Shkup, Kumanovë), maqedonasit etnikë (Tetovë dhe Gostivar), ose disa pakica që së bashku përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë (Manastir, Shtip, Strumicë, Prilep, Veles, Kriva Pallankë). Dibra është ndër qytetet e pakta ku jetojnë maqedonasit dhe shqiptarët, dhe ku nuk është regjistruar asnjë krim i vetëm nga urrejtja këtë vit.



3.4. Incidente sipas muajit






Numri më i madh i incidenteve ka ndodhur në shtator (25). Këtë muaj pati incidente ndërmjet të rinjve nga vendbanime të përziera etnike dhe/ose shkolla, linja autobusi të përdorura nga anëtarë të komuniteteve të ndryshme etnike. Në prill dhe qershor ka pasur 16 incidente, 20 në tetor, 18 në korrik dhe nëntor, 17 në maj, 15 në gusht, 14 në shkurt dhe dhjetor, 7 në janar dhe 5 në mars.

Incidente sipas muajit




3.5. Incidentet bazuar në motivim të njëanshëm

Baza etnike (179 incidente, 90.86%) përsëri zë pjesën më të madhe të bazave për krimet e kryera nga urrejtja në vitin 2023. Motivi në 2 incidente është bindja politike dhe përcaktimi politik, 6 incidente kanë ndodhur si rezultat i bindjeve fetare, 2 incidente janë motivuar nga orientimi seksual dhe 8 incidente kanë ndodhur bazuar në disa karakteristika të tjera të mbrojtura.


	Përkatësia etnike	179
	Bindja politike ose përkatësia politike	2
	Bindja fetare	6
	Orientimi seksual	2
	Karakteristika të tjera të mbrojtura	8

3.6. Viktimat dhe autorët


Viktimat dhe autorët janë kryesisht të rinj dhe anëtarë të komuniteteve të ndryshme etnike, anëtarë të klubeve të tifozëve të ekipeve sportive ose mbështetës të partive politike. Komiteti i Helsinkit regjistroi gjithsej 197 raste në të cilat 213 persona dhe 292 autorë ishin viktimë. Numri i saktë i autorëve nuk mund të përcaktohet për shkak të mungesës së informacionit të ndarë nga autoritetet kompetente. 142 nga 213 viktimë janë të mitur ndërsa nga 292 autorë, 132 janë të mitur.



Përfshirja e të miturve në numrin e përgjithshëm të viktimave



Përfshirja e të miturve në numrin e përgjithshëm të autorëve



3.7. Analiza e sistemit shtetëror për statistikën e krimit nga urrejtja në prokuroritë dhe gjykatat publike në vend

Duke marrë parasysh se regjistrimi dhe mbledhja e statistikave të besueshme për krimin nga urrejtja është thelbësore për formimin efektiv të politikave dhe për marrjen e masave të duhura për adresimin e incidenteve të motivuara nga urrejtja, ekipi i projektit siguroi analiza të sistemit shtetëror për regjistrimin dhe statistikën për krimet nga urrejtja. Analiza do të përqendrohet në mënyrën se si prokuroritë publike dhe gjykatat në vend grumbullojnë të dhëna për krimet nga urrejtja dhe ofrojnë një pasqyrë të numrit të krimeve të kryera; cilat grupe ato synojnë; numri i veprave penale që janë identifikuar me sukses si krime nga urrejtja; dhe informacion mbi vendimet dhe dënimet e shqiptuara. Shqyrtimi i bërë nga grupi i projektit pas analizimit të informacionit të siguruar nga prokuroritë publike dhe gjykatat është paraqitur në Raportin vjetor për krimin nga urrejtja në vitin 2023.

Për këtë qëllim, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut paraqiti kërkesa për informacion me karakter publik në të gjitha prokuroritë themelore publike dhe në të gjitha gjykatat në vend. Kështu, u kërkuar të dhëna për kallëzimet penale të paraqitura në Prokurorinë Themelore Publike në vitin 2023 dhe për aktakuzat që Prokuroria paraqiti në gjykatën kompetente, për veprat penale ku elementi i urrejtjes ekziston si rrethanë rënduese.¹⁶ Përveç kësaj, prokuroritë publike në vend u pyetën për

¹⁶ Neni 123 paragrafi 2, neni 130 paragrafi 2, neni 131 paragrafi 2, neni 139 paragrafi 2, neni 140 paragrafi 2, neni 142 paragrafi 2, neni 144 paragrafi 3, neni 155 paragrafi 2, neni 186 paragrafi 6, neni 187 paragrafi 2 dhe neni 319.

tiparet e mbrojtura nga neni 122 paragrafi 42 për kallëzimet/aktakuzat penale të paraqitura, për secilën nga veprat penale.

Tri zyra të prokurorisë publike (Resnjë, Kavadar dhe Gostivar) nuk iu përgjigjën kërkesave për informacion me karakter publik. 14 prokurori themelore publike u përgjigjën se nuk kishin marrë kallëzime penale ose nuk kishin ngritur aktakuza për krime nga urrejtja. Prokuroria Themelore Publike Shkup dorëzoi të dhëna për 108 kallëzime penale të pranuar dhe 43 aktakuza të ngritura, duke theksuar se as kallëzimet penale dhe as aktakuzat nuk janë pranuar dhe ngritur në bazë të karakteristikave të mbrojtura nga neni 122 paragrafi 42 i Kodit penal. Prokuroria Themelore Publike në Kumanovë dorëzoi përgjigje për 68 aktakuza penale të pranuar dhe 1 aktakuzë të ngritur. Megjithatë, Prokuroria Publike në Kumanovë nuk dha asnjë informacion në lidhje me karakteristikat e mbrojtura në kallëzimet dhe aktakuzat e theksuara. Prokuroria Themelore Publike Kërçovë dorëzoi të dhëna për 22 kallëzime penale, duke theksuar se në bazë të akuzave të paraqitura dhe seancave dëgjimore të dëshmitarëve në prokurori, nuk është konstatuar se vepra është kryer nga urrejtja, pasi që këto janë raste të dhunës në familje. Për më tepër, Zyra e Prokurorit Publik Kërçovë raportoi për 5 urdhra penalë të paraqitur, duke vënë në dukje se gjatë paraqitjes së aktakuzës në gjykatën kompetente, nuk zbaton nenin 122 paragrafin 42 të Kodit penal, por i referohet bazave të tjera ligjore. Vetëm dy prokurori kanë paraqitur të dhëna të qarta për veprat penale të kryera nga urrejtja. Prokuroria Themelore Publike në Manastir na informoi se në vitin 2023 kanë pranuar vetëm një kallëzim penal për veprën penale të rrezikimit të sigurisë së kryer nga urrejtja në bazë të origjinës etnike, kundër një personi, me të cilin prokurori publik paraqiti propozim të gjykata kompetente për caktimin e masës së sigurisë trajtim i detyrueshëm dhe mbajtje në një institucion shëndetësor. Prokuroria Themelore Publike Veles ka pranuar dy kallëzime penale – një për veprën penale të lëndimit trupor nga urrejtja dhe një kallëzim penal për veprën penale të rrezikimit të sigurisë nga urrejtja për shkak të marrëdhënieve të pazgjdhura pronësore. Në lidhje me kallëzimin penal janë paraqitur dy propozime për lëshimin e urdhrit penal.

Gjykatat në vend u pyetën për numrin e aktakuzave të pranuar dhe numrin dhe llojin e vendimeve të marra për veprat penale nga urrejtja dhe karakteristikat e mbrojtura nga neni 122 paragrafi 42 të Kodit penal. 18 gjykata u përgjigjën se nuk kishin pranuar aktakuza për vepra penale nga urrejtja dhe, për pasojë, nuk kishin marrë vendim. Gjykata Themelore e Ohrit dhe Gjykata Themelore e Negotinës dorëzuan të dhëna për aktakuzat dhe vendimet e marra, por nuk i paraqitën karakteristikat e mbrojtura. Gjykata Themelore Manastir dorëzoi gjithashtu të dhëna për aktakuzat dhe vendimet, por deklaroi se në evidencën e programit ACMIS të gjykatës, nuk janë shënuar karakteristikat e mbrojtura. Gjykata Themelore Koçan dorëzoi të dhëna për 3 aktakuza të pranuar dhe 3 dënime për veprën penale të rrezikimit të sigurisë së kryer nga urrejtja, por karakteristikat e mbrojtura nuk përmenden. Gjykata Themelore Veles raporton se dy aktakuzat e ngritura për vepra penale nga urrejtja në të vërtetë nuk i referohen ekzistencës së një karakteristike të mbrojtur dhe nuk bëhet fjalë për vepra të kryera nga urrejtja. Në vitin 2023, gjykata miratoi aktvendim për lirim për veprën penale të rrezikimit të sigurisë së kryer nga urrejtja ndaj një personi fizik, “e kryer për shkak të lidhjes së supozuar të palës së dëmtuar në lidhje me kombësinë bullgare”. Gjykata Themelore e Gostivarit dhe Gjykata Themelore e Kërçovës dorëzuan të dhëna për aktakuzat dhe aktgjykimet, duke vënë në dukje se këto ishin raste të dhunës në familje, jo krime nga urrejtja. Gjykata Themelore Shkup dorëzoi listën e të gjitha rasteve

përfundimtare dhe të pranuar në lidhje me veprat penale të kërkuara. Gjykata vëren se në lidhje me lëndët që lidhen me karakteristikat e mbrojtura të përmendura në nenin 122 paragrafi 42 të Kodit penal, sistemi nuk i gjeneron ato të dhëna dhe mënyra e vetme për t'i verifikuar ato është nëse bëhet këqyrje në aktgjykimet e përmendura, disa prej të cilave (ato për të cilat ka vendin gjyqësor) tashmë janë në dispozicion me numrin e lëndës në faqen e internetit të gjykatës në formë anonime.

Analiza e të dhënave të siguruara nga gjykatat dhe prokuroritë publike në vend tregon se autoritetet gjyqësore nuk mbajnë statistika të ndara dhe të veçanta për krimet nga urrejtja dhe për veprat penale e kryera gjatë dhunës në familje. Numri i procedurave të filluara për mbrojtjen e viktimave të incidenteve të motivuara nga paragjykimi dhe ndjekjes penale të autorëve është i parëndësishëm, dhe për pasojë nuk ka vendime gjyqësore të mjaftueshme që të nxirret konkluzion se shteti trajton në mënyrë adekuate krimin nga urrejtja. Madje edhe në ato raste kur janë zhvilluar procedura penale, motivi i njëanshëm nuk është përcaktuar qartë dhe karakteristikat e mbrojtura nuk janë specifikuar (si në rastin e propozimit të paraqitur për lëshimin e urdhrit penal në Prokurorinë Publike në Veles për rrezikimin e sigurisë nga urrejtja për *shkak të marrëdhënieve të parregulluara pronësore*), ose nuk është propozuar vendosja e masave të duhura për ballafaqim me krimin nga urrejtja (si në rastin e Prokurorisë Publike Themelore në Manastir, e cila paraqiti një *propozim për vendosjen e masës së sigurisë për trajtim të detyrueshëm dhe mbajtjen në një institucion shëndetësor kundër një personi për vepër penale të kryer Rrezikim i sigurisë, i kryer nga urrejtja në bazë të origjinës etnike*).

4. AKTIVITETET E EKIPIT

TË PROJEKTIT

Aktivitetet synojnë të ofrojnë tregues mbi vëllimin, natyrën dhe shpeshësinë e krimeve nga urrejtja të kryera në vend. Qëllimi është të punohet përmes kësaj qasjeje për të parandaluar krimet nga urrejtja dhe gjuhën e urrejtjes duke përmirësuar ligjet, duke rritur ndërgjegjësimin e publikut dhe duke ndërtuar kapacitetet e organeve të drejtësisë penale dhe duke regjistruar incidente të njëanshme.

4.1. Ofrimi i ndihmës juridike për viktimat e incidenteve të urrejtjes dhe monitorimi i gjykimeve për raste të caktuara të krimeve të urrejtjes të kryera në baza të ndryshme të mbrojtura

Në vitin 2023, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ofroi ndihmë juridike falas në katër raste të krimeve nga urrejtja – dy incidente u kryen në bazë të orientimit seksual dhe/ose identitetit gjinor, një në bazë të përkatësisë etnike, racës dhe ngjyrës së lëkurës, dhe një në bazë të përkatësisë dhe besimit fetar. Ndihma juridike falas nënkuptonte ofrimin e këshillave ligjore dhe informacionit ligjor mbi mekanizmat mbrojtës në dispozicion të viktimave, komunikimin me institucionet kompetente, përpilimin dhe ngritjen e kallëzimeve penale në zyrat e prokurorisë publike dhe monitorimin e procedurave gjyqësore për krimin nga urrejtja.

Një nga këto raste përfshinte dy persona LGBTI të cilët u sulmuan në një kafene lokale. Autorët gjithashtu drejtuan edhe sulme verbale ndaj tyre për shkak të orientimit të tyre seksual. Viktimave u është ofruar ndihmë juridike – u është shpjeguar procedura për ndjekje penale të veprave nga urrejtja, janë këshilluar të hartojnë dokumentacion mjekësor dhe u është ofruar mundësia e shoqërimit para stacionit kompetent të policisë për të raportuar ngjarjen, si dhe mundësia e paraqitjes së ankesës penale në Prokurorinë Themelore Publike. Viktimat vendosën të mos e raportojnë ngjarjen në stacion policor dhe të mos kryejnë asnjë procedurë.

Më 7 qershor 2023, në media u publikuan lajme për grafitë ofenduese me kryqe dhe mbishkrime “Gjupci”, të vizatuara me sprej të zi në shtëpitë e popullatës romë në rrugën Debarska në Manastir. Është një rast tjetër i krimit nga urrejtja, me një mesazh që bën thirrje për dhunë ndaj komunitetit etnik rom. Më 15 qershor në Manastir, Komiteti i Helsinkit u takua me një banor të rrugës Debarska, i cili na dha më shumë informacion për vetë ngjarjen, si dhe për faktin se kjo nuk është hera e parë që ka ndodhur ky lloj frikësimi dhe është penguar siguria e popullsisë romë atje. Nëpunësit policorë dolën në terren, por banorët nuk kanë informacion për veprime të mëtejshme. Një pjesë e grafitëve u pastruan nga vetë banorët, por pas dokumentimit të grafitëve të mbetura, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut së bashku me një person në cilësinë e të dëmtuarit përgatitën një ankesë penale në Prokurorinë Publike Manastir për kryerjen e veprës penale “Nxitje e urrejtjes, përçarjes ose intolerancës mbi baza kombëtare, racore, fetare dhe të tjera diskriminuese” nga neni 319c “Rrezikimi i

sigurisë” në lidhje me nenin 144 paragrafi 3 të Kodit penal. Ndërkohë, pak para paraqitjes së kallëzimit penal, i dëmtuari është sulmuar fizikisht në të njëjtin vend ku është shkruar grafiti, me supozimin se sulmi është kryer nga të njëjtët autorë. Pas disa tentativave dhe këshillimeve ligjore, i dëmtuari ka vendosur të mos nisë procedimin penal.

Në qershor, Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut iu drejtua drejtori i Muzeut të Holokaustit të Hebrenjve në Maqedoni, i cili na informoi se grupi i tifozëve Ballistët nga Tetova kishte pikturuar grafitë me simbole naziste në disa vende të qytetit. Përveç kësaj, ai ndau me ne reagimet e komunitetit hebre ndaj ngjarjeve të mëparshme në Karnavalin në Strumicë, ku kishte një maskë me imazhin e Hitlerit, si dhe mbishkrime me kryqin nazist në gardhin e komunitetit hebre.

Në tetor, të punësuar në “Komitetit” raportuan në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut se gjatë fundjavës një shtetas i huaj i identifikuar si homoseksual u sulmua fizikisht nga dy persona të punësuar nga Giro Beko. Ai pësoi lëndime të rënda trupore, por menjëherë pas raportimit ai u largua nga vendi. Nëpunësit policorë nga Stacioni policor Qendër menjëherë u paraqitën në vendin e ngjarjes dhe biseduan me autorët dhe dëshmitarët. Komiteti i Helsinkit ishte në takim me kryeshefin e Njësisë për Krim të Dhunshëm në Stacionin policor Kisella Voda, i cili mori përsipër rastin dhe na informoi se ata do të paraqesin kallëzim penal ex officio për lëndime të rënda trupore. Me kërkesën tonë të kualifikohet si vepër nga urrejtja për shkak të treguesve të qartë të njëanshëm, krye shefi sugjeroi se për këtë do të vendosë prokurori publik.

Mirëmbajtja, përditësimi dhe promovimi i faqes së internetit www.zlostorstvaodomraza.com në **gjuhën maqedonase, shqip dhe anglisht**

Ueb portali – www.zlostorstvaodomraza.com, i disponueshëm që nga viti 2013, është një mjet interaktiv për informimin e qytetarëve për krimet e kryera nga urrejtja dhe raportimin e incidenteve nga përdoruesit e tij. Përmban një hartë interaktive që tregon vendndodhjen e saktë ose të përafërt ku ka ndodhur incidenti. Faqja kryesore ofron kategori të krimeve nga urrejtja dhe motive të njëanshme, shfaqen informacione se si qytetarët mund të raportojnë incidentet, përmes një aplikacioni elektronik, formularët e postës elektronike dhe internetit, si dhe grafikët statistikorë. Mund të gjenden gjithashtu tabela për pyetje të shpeshta, burime dhe fjalor në ueb portalin që publikojnë rregullisht informacione në lidhje me projektin, rëndësinë dhe fushëveprimin e krimeve nga urrejtja, si dhe publikime në lidhje me këtë fenomen. Të gjitha materialet janë në dispozicion në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze.

4.2. Monitorimi dhe raportimi i krimeve dhe incidenteve nga urrejtja, me vëmendje të veçantë ndaj dhunës politike, sportive, bashkëmoshatare dhe dhunës së kryer me motivim të njëanshëm midis të rinjve

Komiteti i Helsinkit vazhdoi të monitorojë numrin e gazetave të përditshme me pikëpamje të ndryshme ideologjike dhe përkatësi politike në vitin 2023. Monitorimi elektronik i mediave bëhet çdo ditë, përmes dy gjeneratorëve më të njohur të lajmeve në internet (www.time.mk dhe www.grid.mk), si dhe duke përdorur opsionet e avancuara të kërkimit në seksionin “lajme” të www.google.com. Qëllimi kryesor i monitorimit të mediave është të identifikojë ndodhitë e mundshme të incidenteve

nga urrejtja dhe të ftojë viktimat e pretenduara në një intervistë, si dhe t'u ofrojë atyre mundësinë e ndihmës juridike ose monitorimit të procesit gjyqësor për rastin e tyre.

4.3. Përpilimi dhe publikimi i buletineve mujore mbi situatën e krimeve të urrejtjes në vend bazuar në të dhënat e grumbulluara dhe të analizuara nga puna e Komitetit të Helsinkit dhe dy rrjeteve – Rrjetit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Rrjetit Kombëtar kundër Homofobisë dhe Transfobisë

Gjatë periudhës raportuese, Komiteti i Helsinkit përpiloi 9 buletine mujore për çdo muaj, të publikuara në faqen e internetit www.zlostorstvaodomraza.com/izvestaji/:

1. Buletini për muajin prill, botuar më 10 maj 2023
2. Buletini për muajin maj, botuar më 10 qershor 2023
3. Buletini për muajin qershor, botuar më 10 korrik 2023
4. Buletini për muajin korrik, botuar më 10 gusht 2023
5. Buletini për muajin gusht, botuar më 10 shtator 2023
6. Buletini për muajin shtator, botuar më 10 tetor 2023
7. Buletini për muajin tetor, botuar më 10 nëntor 2023
8. Buletini për muajin nëntor, botuar më 10 dhjetor 2023
9. Buletini për muajin dhjetor, botuar më 31 dhjetor 2023

4.4. Përgatitja, përkthimi dhe lëshimi i raportit të monitorimit në vitin 2022 në gjuhën maqedonase, shqip dhe anglisht

Raporti vjetor u përgatit, u përkthye dhe u botua në internet në ueb faqen të Komitetit të Helsinkit dhe [portalit](http://portalit.zlostorstvaodomraza.com) www.zlostorstvaodomraza.com në qershor 2023. Një kopje e raportit, ashtu si në vitet e mëparshme, u dërgua me postë dhe në mënyrë elektronike në të gjitha institucionet, mediat dhe organizatat përkatëse.

3.4.1. Përgatitja, lëshimi, promovimi dhe shpërndarja e një infografiku që do të ofrojë një përmbledhje të shkurtër të të dhënave për krimet nga urrejtja të regjistruara në vitin 2022;

Bazuar në të dhënat në raportin vjetor, u përgatit, u përkthye dhe u botua një infografik me një përmbledhje të shkurtër të konstatimeve dhe trendeve të krimeve nga urrejtja të regjistruara në vitin 2022.¹⁷

3.4.2. Pasqyrë e incidenteve të raportuara të krimeve nga urrejtja dhe kontributi në Raportin vjetor të ODIHR-së 2022 për krimet dhe incidentet nga urrejtja në rajonin e OSBE-së;

Në qershor 2022, KHM dërgoi Raportin vjetor të vitit 2023 për krimet nga urrejtja në OSBE/ODIHR dhe është ende e vetmja organizatë joqeveritare që dërgon sistematikisht informacion në

¹⁷ Në dispozicion në: <https://zlostorstvaodomraza.com/wp-content/uploads/2023/09/mkd2022-1.pdf>

OSBE/ODIHR për situatën e krimeve nga urrejtja në vend. Komiteti i Helsinkit raporton rregullisht për incidente dhe krime të regjistruara nga urrejtja dhe në maj 2023 i dërgoi OSBE/ODIHR kontributin e tij me incidente të regjistruara për vitin 2022.

4.5. Analiza e sistemit shtetëror për statistikat e krimit nga urrejtja në prokuroritë dhe gjykatat publike në vend

Duke marrë parasysh se regjistrimi dhe mbledhja e statistikave të besueshme për krimin nga urrejtja është thelbësore për formimin efektiv të politikave dhe për marrjen e masave të duhura për adresimin e incidenteve të motivuara nga urrejtja, ekipi i projektit siguroi analiza të sistemit shtetëror për regjistrimin dhe statistikat për krimet nga urrejtja.

Analiza e të dhënave të siguruara nga gjykatat dhe prokuroritë publike në vend tregon se autoritetet gjyqësore nuk mbajnë statistika të ndara dhe të veçanta për krimet nga urrejtja dhe për veprat penale të kryera gjatë dhunës në familje. Numri i procedurave të filluara për mbrojtjen e viktimave të incidenteve të motivuara nga paragjykimi dhe ndjekjes penale të autorëve është i parëndësishëm, dhe për pasojë nuk ka vendime gjyqësore të mjaftueshme që të nxirret konkluzion se shteti trajton në mënyrë adekuate krimin nga urrejtja. Madje edhe në ato raste kur janë zhvilluar procedura penale, motivi i njëanshëm nuk është përcaktuar qartë dhe karakteristikat e mbrojtura nuk janë specifikuar (si në rastin e propozimit të paraqitur për lëshimin e urdhrit penal në Prokurorinë Publike në Veles për rrezikimin e sigurisë nga urrejtja për shkak të marrëdhënieve të parregulluara pronësore), ose nuk është propozuar vendosja e masave të duhura për ballafaqim me krimin nga urrejtja (si në rastin e Prokurorisë Publike Themelore në Manastir, e cila paraqiti një propozim për vendosjen e masës së sigurisë për trajtim të detyrueshëm dhe mbajtjen në një institucion shëndetësor kundër një personi për vepër penale të kryer Rrezikim i sigurisë, i kryer nga urrejtja në bazë të origjinës etnike).

4.6. Festimi i Ditës Botërore të Diversitetit Kulturor me organizimin e veprimtarisë “Turlitava 7”

Me qëllim të shënimit të Ditës Botërore të Diversitetit Kulturor, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut organizoi për herë të shtatë, të premten (19 maj) ngjarjen “Turlitava – Së bashku është më ëmbël!” mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Shkup.

Ideja për ngjarjen ishte tejkalimi i mosnjohjes reciproke, të grupeve të ndryshme etnike në vendin tonë, si arsyeja më e zakonshme për krijimin e situatave të konfliktit, përkatësisht, situatave që çojnë në krime nga urrejtja.

Përmes fjalimeve të Drejtoreshës Ekzekutive të Komitetit të Helsinkit, Uranija Pirovska dhe Shefit të Misionit të OSBE-së në Shkup, Ambasadorit Kilian Wahl, si dhe përmes muzikës dhe një sërë pjatash të shijshme tradicionale, kemi treguar se diversiteti bashkon dhe plotëson.

Diversiteti është “mëlmesa” që e bën jetën më të mirë dhe më të pasur. Së bashku është më ëmbël.





5. KONKLUZIONE

Maqedonia e Veriut ende mbetet prapa në marrjen e masave sistematike për parandalimin e krimit nga urrejtja dhe për grumbullimin në mënyrë adekuate të të dhënave në këtë fushë. Krimet nga urrejtja zakonisht nuk raportohen dhe kur raportohen ato përfundojnë si ankesa formale pa hetime të duhura nga autoritetet, sepse vetë ata nuk janë të trajnuar të identifikojnë dhe t'iu përgjigjen krimeve nga urrejtja. Të rinjtë janë më të ndikuar nga e gjithë kjo, veçanërisht të rinjtë që i përkasin një grupi minoritar siç është komuniteti LGBTI, të cilët lihen vetëm, pa mbështetje sistematike të karakteristikave të tyre të identitetit.

Raporti përfundon se krimet nga urrejtja zakonisht ndodhin në publik dhe se një numër i madh i incidenteve ndodhin në autobusë, afër stacioneve të autobusëve, rreth shkollave dhe afër stacioneve të trenit. Shumë krime nga urrejtja kryhen për hakmarrje ose si pasojë e incidenteve të mëparshme midis maqedonasve të rinj etnikë dhe shqiptarëve etnikë. Duke pasur parasysh përpjekjen shumë të vogël të investuar në drejtim të masave parandaluese, edukimit për të drejtat e njeriut dhe ndërgjegjësimin të publikut, pritet që rritja e tendencave negative të vazhdojë për sa kohë që institucionet e injorojnë problemin. Konkluzionet e raportit mund të paraqiten shkurtimisht në disa pika:

- Numri i incidenteve të regjistruara dhe krimeve të mundshme nga urrejtja në vitin 2023 u rrit me 23% krahasuar me vitin 2022;
- Incidentet që ndodhin në bazë të përkatësisë etnike janë ende më të përhapura me 90.86% të numrit të përgjithshëm të incidenteve të regjistruara;
- Të rinjtë janë ende kryesisht të përfshirë në incidente të motivuara nga paragjykimi, si autorë ashtu edhe viktime. Komiteti i Helsinkit regjistroi gjithsej 197 raste në të cilat 213 persona dhe 292 autorë ishin viktime. 142 nga 213 viktime janë të mitur ndërsa nga 292 autorë, 132 janë të mitur;
- Ndërsa po ndërmerren disa hapa për të forcuar mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI, ata ende e gjejnë veten në rrezik më të madh të akteve të motivuara nga paragjykimi, veçanërisht gjatë dhe pas Paradës së Krenarisë. Megjithatë, vërehen ndryshime të caktuara në shoqëri, gjë që tregohet edhe nga fakti se komuniteti LGBTI inkurajohet gjithnjë e më shumë të kontaktojë OJQ-të që punojnë në këtë fushë dhe të përdorin shërbimet e tyre, siç janë ndihma dhe mbështetja juridike falas. Një ndikim i rëndësishëm në rritjen e besimit të komunitetit LGBTI janë dy vendimet¹⁸ pozitive të gjykatës që dënuan me burgim autorët e veprës penale nga urrejtja në bazë të orientimit seksual.
- Ende nuk mbahen statistika adekuate për incidentet e motivuara nga paragjykimet nga autoritetet kompetente. Megjithëse Ministria e Punëve të Brendshme udhëheq dhe publikon disa statistika

18 Shih më shumë në: <https://www.radiomof.mk/lgbti-junajted-kazna-zatvor-od-6-meseci-za-liceto-koe-fizichki-go-napadna-aktivistot-bekim-asani/> dhe <https://libertas.mk/dve-godini-zatvor-za-liceto-shto-go-napadna-aktivistot-bekim-asani-na-ploshtheadot-skenderbeg-vo-skop-e/>

në raportet e saj vjetore, megjithatë, duket se raportimi nuk ka bërë një dallim të qartë midis gjuhës së urrejtjes dhe krimeve nga urrejtja.

- Është bërë shumë pak përpjekje për vendosjen e masave parandaluese, duke përfshirë edukimin për të drejtat e njeriut dhe ndërgjegjësimin e publikut, veçanërisht në mesin e nxënësve të shkollave të mesme dhe të rinjve, duke pasur parasysh se shumica e viktimave janë të mitur ose të rinj;
- Motivi i njëanshëm, në vend që të transferohet nga policia në prokurori dhe më vonë në gjykata, si element kryesor në rastet e krimeve nga urrejtja, “humbet” gjatë gjithë procesit;

6. REKOMANDIME

Angazhimi publik forcon besimin në institucione. Prokurorët publikë nuk duhet të presin që të ndodhë një krim nga urrejtja që do të tërheqë vëmendjen dhe do të mbulohet nga media për të filluar krijimin e kontakteve me komunitetin. Komunikimi dhe konsultimi i rregullt me grupet e komunitetit mund të japë rezultate pozitive drejt një gatishmërie më të madhe të viktimave dhe dëshmitarëve për të bashkëpunuar me policinë dhe për të rritur të kuptuarit e tyre për atë që po ndodh në komunitet. Përmes kontakteve të tilla, do të jemi të sigurt se duke pasur parasysh tensionet në rritje midis komuniteteve, policia mund të qetësojë më mirë situatën dhe të dijë se kur duhet të rritet prania e policisë për të zgjidhur problemet që prekin komunitetin. Prandaj, i japim rekomandimet e mëposhtme:

- Hetimi dhe ndjekja penale në kohë dhe efektive e krimeve nga urrejtja duke marrë parasysh motivet e njëanshme gjatë procedurave penale;
- Marrja e masave të duhura për të lehtësuar raportimin e krimeve nga urrejtja nga viktimat, duke përfshirë masat për të forcuar besimin në polici dhe institucione të tjera shtetërore;
- Grumbullimi dhe nxjerrja e të dhënave gjithëpërfshirëse dhe krahasuese për krimet nga urrejtja, për aq sa është e mundur, si dhe numri i këtyre incidenteve të raportuara nga publiku dhe të regjistruara nga autoritetet policore, numri i dënimeve, motivet e njëanshme pas këtyre krimeve dhe dënimet e shqiptuara;
- Vendosja dhe ruajtja e bashkëpunimit midis autoriteteve shtetërore dhe OJQ-ve në aspekte të ndryshme të punës për të trajtuar krimet nga urrejtja, siç janë trajnimi, mbështetja e viktimave dhe rritja e raportimit;
- Ky bashkëpunim duhet të bazohet në shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit, veprimin e përbashkët që synon zbulimin e motiveve të njëanshme, bashkëpunimin për të zhvilluar udhëzime, rregulla dhe trajnime për regjistrimin e incidenteve nga urrejtja, duke përfshirë shkëmbimin e ekspertizës për të zhvilluar, promovuar dhe rishikuar treguesit e njëanshëm;
- Sigurimi i mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave të krimeve nga urrejtja;
- Përmirësimi i komunikimit dhe koordinimit midis të gjitha autoriteteve dhe institucioneve kompetente në fushën e krimeve nga urrejtja;
- Kryerja e hulumtimeve në nivel kombëtar për masat për të trajtuar krimet nga urrejtja, si një burim kryesor informacioni për përfaqësimin e krimeve nga urrejtja në vend;
- Promovimi i trajnimit për institucionet përkatëse që vijnë në kontakt me viktimat e krimit nga urrejtja, në mënyrë që ata të mund t' i ndihmojnë në mënyrë efektive; dhe
- Masa të shumta parandaluese, ndër të tjera duke rikthyer konceptin e kujtimit në arsimin për të drejtat e njeriut, programe mësimore për histori dhe trajnime përkatëse, duke ndërmarrë hapa për të edukuar publikun, veçanërisht të miturit dhe të rinjtë, për vlerat e diversitetit dhe përfshirjes kulturore, dhe duke u përpjekur që të gjithë sektorët e shoqërisë të luajnë një rol në luftimin e një intolerance të tillë.

SHTOJCË INCIDENTE TË REGJISTRUARA NGA URREJTJA PËR VITIN 2023

1. Incident nga urrejtja midis të miturve në Parkun e Qytetit në Shkup

Incidentet e shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Më 7 prill 2023, prindërit raportuan se fëmijët e tyre të mitur u sulmuan nga tre autorë të panjohur në Parkun e Qytetit në Shkup, pa asnjë arsye të njohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Diferenca e supozuar në origjinën etnike

Mungesa e motiveve të tjera – viktimat u sulmuan për asnjë arsye të njohur

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Emri i lokacionit Parku i qytetit

Numri i viktimave 1

Numri i kryerësve - 3

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Sulm fizik Dhunë

2. Incident nga urrejtja midis të miturve

Incidentet e shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Më 7 prill 2023, një prind raportoi se djali i tyre i mitur u sulmua nga dy të mitur të tjerë në rrugë në vendbanimin Gjorçe Petrov, pa asnjë arsye të njohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Diferenca e supozuar në origjinën etnike

Mungesa e motiveve të tjera – viktimat u sulmuan për asnjë arsye të njohur

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Emri i lokacionit rrugë në Gjorçe Petrov

Numri i viktimave1

Numri i kryerësve - 2

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Sulm fizik

3. Incidenti në ndeshjen e futbollit midis “Vardarit” nga Brvenica dhe “Besës” nga Çellopeku

[Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike](#)

[Incidente të kryera në gara sportive](#)

Çka ndodhi: Më 9 prill 2023, në SPB Tetovë, u raportua se gjatë gjysmës së dytë të ndeshjes së futbollit të kampionatit midis ekipeve të “Vardarit” nga Bërvenica dhe “Besës” nga Çellopeku, të pakënaqur me vendimin e marrë nga arbitri, dyzet tifozë dhe lojtarë rezervë të “Besës” hynë në fushë dhe u përpoqën të përballen fizikisht me arbitrat dhe delegatin në ndeshje. Me ndërhyrjen e nëpunësve policorë të SPB Tetovë, ata u penguan në qëllimin e tyre, por vazhduan të sillen në mënyrë agresive, pas së cilës ndeshja u ndërpre.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Përkatësia etnike – tifozët e të dy ekipeve të futbollit janë anëtarë të bashkësive të ndryshme etnike

Vendndodhja – ngjarja u zhvillua në një ndeshje futbollit

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave - 4

Numri i kryerësve - 40

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Dhunë

4. Incidenti midis QKV “Borec” nga Velesi dhe KV “Shkëndija” nga Tetova

[Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike](#)

[Incidente të kryera në gara sportive](#)

Çka ndodhi: Më 10.04.2023 në SPB Veles, u raportua se rreth orës 21:10 në sallën sportive «Gemixhii» në Veles, pas luajtjes së ndeshjes së volejbollit midis ekipeve të QKV “Borec” nga Veles dhe KV “Shkëndija” nga Tetova, u prish rendi dhe qetësia publike, ku disa nga lojtarët e ekipit mysafir

dhe disa nga shikuesit hodhën objekte të ndryshme në drejtim të njëri-tjetrit. Kështu, një nëpunës policor dhe një lojtar i KV “Shkëndija” pësuan lëndime.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Përkatësia etnike – tifozët e të dy ekipeve të futbollit janë anëtarë të bashkësive të ndryshme etnike

Vendndodhja – ngjarja u zhvillua në një sallë sportive gjatë një ndeshje volejboli

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Emri i lokacionit Salla e Sporteve “Gemixhii” në Veles

Numri i viktimave - /

Numri i kryerësve - /

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Dhunë

5. U dëmtua pllaka përkujtimore e një kompleksi përkujtimor që përkujton dëshmorët martirë shqiptarë në Sopot, rajoni i Kumanovës

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Më 16 prill 2023, mediat raportuan se pllaka përkujtimore në kompleksin përkujtimor të ndërtuar për nder të dëshmorëve shqiptarë që vdiqën gjatë masakrës, të kryer më 4 nëntor 1944 kundër popullsisë së pambrojtur të këtij fshati, ishte thyer në fshatin Sopot të Kumanovës. Sipas Kryetarit të Këshillit Organizativ të këtij kompleksi përkujtimor, Shukri Masurica, ky është një vandalizëm i një objekti përkujtimor dhe u bëri thirrje organeve përgjegjëse të hetojnë rastin.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Origjina etnike – dallimi i supozuar në origjinën etnike të autorëve

Vendndodhja - një kompleks përkujtimor i ndërtuar për të përkujtuar dëshmorët martirë shqiptarë

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Emri i lokacionit kompleksi përkujtimor i ndërtuar në nder të dëshmorëve martirë shqiptarë në Sopot, Kumanovë

Numri i viktimave /

Numri i kryerësve - /

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Dëmtimi i simboleve

6. Incident nga urrejtja ndërmjet të miturve në shkollë fillore në Çair

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Më 18 maj 2023, një prind raportoi se djali i tij i mitur u sulmua nga një bashkëmoshatar në një fushë sportive në një shkollë fillore në lagjen Qendër, pa asnjë arsye të njohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Diferenca e supozuar në origjinën etnike

Mungesa e motiveve të tjera – viktimat u sulmua për asnjë arsye të njohur

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Emri i lokacionit fusha sportive në shkollën fillore në Qendër

Numri i viktimave 1

Numri i kryerësve - 1

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Sulm fizik

7. Incident nga urrejtja për shkak të përkatësisë etnike

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Më 22 maj 2023, një 18-vjeçar nga Studeniçani raportoi se ai dhe shoku i tij u sulmuan nga dy autorë, pa asnjë arsye të njohur, dhe një nga autorët i kërcënoi ata me thikë.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Diferenca e supozuar në origjinën etnike – në Komunën e Studeniçanit jetojnë anëtarë të bashkësive të ndryshme etnike

Mungesa e motiveve të tjera – viktimat u sulmuan për asnjë arsye të njohur

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave 2

Numri i kryerësve - 2

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Sulm fizik

8. Incident ndërmjet të miturve jashtë një qendre tregtare në Aerodrom

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Më 2 qershor 2023, tre prindër raportuan se fëmijët e tyre të mitur u sulmuan nga një grup të miturish jashtë një qendre tregtare në Aerodrom.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Diferenca e supozuar në origjinën etnike

Mungesa e motiveve të tjera – viktimat u sulmuan për asnjë arsye të njohur

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Emri i lokacionit Qendër tregtare

Numri i viktimave 3

Numri i kryerësve - /

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Sulm fizik Dhunë

9. Sulmohet mbrojtësi i një institucioni publik për kujdes të fëmijëve

Çka ndodhi: Një punonjës i një institucioni publik për kujdesin e fëmijëve raportoi se më 6 qershor 2023, një grup prej tre të miturish sulmuan fizikisht mbrojtësin e tyre, në rrugë.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është statusi shoqëror dhe përkatësia në një komunitet të marginalizuar, ndërsa treguesit e njëanshëm janë:

Statusi social, përkatësia në një komunitet të marginalizuar

Mungesa e motiveve të tjera – viktimat u sulmuan për asnjë arsye të njohur

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme në shoqëri.

Numri i viktimave 1

Numri i kryerësve - 3

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Sulm fizik Dhunë

10. Incident në transportin publik në Shkup

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Një prind i një të mituri raportoi se djali i tij u sulmua fizikisht nga disa autorë në një autobus në Shkup, më 9 qershor 2023

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Diferenca e supozuar në origjinën etnike

Mungesa e motiveve të tjera – viktimat u sulmuan për asnjë arsye të njohur

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave1

Numri i kryerësve - /

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Sulm fizik Dhunë

11. Një i mitur u sulmua fizikisht në Karposh

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Një prind i një të mituri raportoi se djali i tij u sulmua fizikisht nga disa autorë në Karposh më 12 qershor 2023, pa ndonjë arsye të veçantë.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Diferenca e supozuar në origjinën etnike

Mungesa e motiveve të tjera – viktimat u sulmuan për asnjë arsye të njohur

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave1

Numri i kryerësve - /

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Sulm fizik Dhunë

12. I mitur u sulmua fizikisht në Gazi Babë

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Një prind raportoi se djali i tij i mitur u sulmua fizikisht më 28 qershor 2023, në rrugën në Gazi Babë nga një autor i mitur, pa ndonjë arsye të veçantë.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Diferenca e supozuar në origjinën etnike

Mungesa e motiveve të tjera – viktimat u sulmuan për asnjë arsye të njohur

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave1

Numri i kryerësve - 1

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit? Sulm fizik Dhunë

13. Disa të mitur sulmuan një të mitur në Gjorçe Petrov

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Një prind i një të mituri më 30 qershor 2023 raportoi se djali i tij u sulmua fizikisht nga disa të mitur në rrugën në Gjorçe Petrov, pa ndonjë arsye të veçantë.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Diferenca e supozuar në origjinën etnike

Mungesa e motiveve të tjera – viktimat u sulmuan për asnjë arsye të njohur

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave1

Numri i kryerësve - /

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Sulm fizik Dhunë

14. Një grup të miturish sulmuan fizikisht një të mitur

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Një prind i një të mituri raportoi se më 8 korrik 2023, një grup të miturish sulmuan djalin e tij në rrugën në Gjorçe Petrov, pa ndonjë arsye të veçantë.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Diferenca e supozuar në origjinën etnike

Mungesa e motiveve të tjera – viktimat u sulmuan për asnjë arsye të njohur

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave1

Numri i kryerësve - /

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Sulm fizik Dhunë

15. I mitur sulmon një tjetër të mitur në transportin e qytetit të Shkupit

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Gjyshi raportoi se më 22 korrik 2023 rreth orës 18:30 në zonën e Bit Pazarit, në një autobus të NPT-së, nipi i tij i mitur u sulmua fizikisht nga një person.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Diferenca e supozuar në origjinën etnike

Mungesa e motiveve të tjera – viktimat u sulmuan për asnjë arsye të njohur

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave1

Numri i kryerësve - 1

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Sulm fizik Dhunë

16. Dëmtimi i automjetit për shkak të përkatësisë politike

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë politike

Çka ndodhi: Një automjet pasagjerësh (modeli Audi A6) në pronësi të një 35-vjeçari vendas u dogj ndërsa ishte i parkuar në rrugë. Departamenti lokal i zjarrfikësve arriti të shuajë zjarret dhe një ekip i Departamentit të Policisë Kriminale inspektoi vendin. E gjithë pjesa e përparme dhe pjesa e poshtme e automjetit u dëmtuan nga zjarri. Sipas informacionit të ndarë nga mediat, makina është përdorur privatisht nga zëvendëskryeministri Artan Grubi, megjithëse ishte regjistruar me një emër tjetër. Makina ishte parkuar në vendin ku jeton z. Grubi. Mediat zbuluan se dy persona mbërritën në vendngjarje me një makinë pik-up, i hodhën benzinë makinës dhe i vunë flakën.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike, ndërsa treguesit e njëanshëm janë:

Përkatësia politike – automjeti i dëmtuar i përket një funksionari të BDI-së

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe në shoqëri.

Numri i viktimave - /

Numri i kryerësve - 2

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Dëmtimi i pronës

17. Dëmtimi i automjetit për shkak të përkatësisë politike

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë politike

Çka ndodhi: Në komunën e Aerodromit më 24 korrik 2023, u vandalizua automjeti i Marija Mitevës, zëdhënëse e partisë politike VMRO-DPMNE. Autorët kane thyer xhamin e pasmë të makinës ndërkohë që ajo ishte e parkuar në rrugën përballë ndërtesës banesore ku ajo banon

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike, ndërsa treguesit e njëanshëm janë:

Përkatësia politike – automjeti i dëmtuar i përket zëdhënëses së partisë politike VMRO-DPMNE

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe në shoqëri.

Numri i viktimave - /

Numri i kryerësve - /

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Dëmtimi i pronës

18. I mitur sulmohet në Kisella Vodë

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Një prind i një të mituri raportoi se djali i tij u sulmua më 26 korrik 2023 nga një person 22-vjeçar në një rrugë në Kisella Vodë, pa ndonjë arsye të veçantë.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Diferenca e supozuar në origjinën etnike

Mungesa e motiveve të tjera – viktimat u sulmuan për asnjë arsye të njohur

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave1

Numri i kryerësve - 1

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Sulm fizik Dhunë

19. Incident në autobus në zonën e Bit Pazarit

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Një prind raportoi se më 28 korrik 2023 në një autobus në zonën e Bit Pazarit djali i saj u sulmua fizikisht nga disa persona, dhe një nga personat e goditi atë me një objekt të fortë.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Diferenca e supozuar në origjinën etnike

Mungesa e motiveve të tjera – viktimat u sulmuan për asnjë arsye të njohur

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave1

Numri i kryerësve - /

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Sulm fizik Dhunë

20. Incident në ndeshjen ndërmjet “Levskit” dhe “Shkupit”

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Incidente të kryera në gara sportive

Çka ndodhi: Pas ndeshjes së futbollit ndërmjet “Levskit” nga Bullgaria dhe “Shkupit” nga Shkupi, disa banorë nga lagjja Çair sulmuan makina me targa bullgare dhe një person u plagos rëndë. Sulmi u regjistrua nga kalimtarët e rastit. Sipas Prokurorisë, tifozët bullgarë me dy automjete po lëviznin pranë qendrës tregtare “Çairçanka”, ku së pari u futën në një mosmarrëveshje verbale me kalimtarët dhe qytetarët, e cila u kthye në një përleshje fizike. Pastaj tifozët bullgarë ndaluan automjetet dhe dolën prej tyre, pas së cilës argumenti verbal u kthye në një zënkë me një grup qytetarësh që dolën nga ndërtesat përreth. Pas kthimit në makinë, një shtetas bullgar 29-vjeçar u godit me një objekt të mprehtë në stomak.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Shtetësia – incident ndërmjet shtetasve të Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut

Koha – incidenti ka ndodhur pas përfundimit të një ndeshjeje futbollit

Modeli i incidenteve të mëparshme - përplasje fizike ndërmjet grupeve të tifozëve

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend, bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme në shoqëri dhe sigurinë e njerëzve të pranishëm në ose pranë garave sportive.

Numri i viktimave - /

Numri i kryerësve - 21

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Sulm fizik Dhunë

21. Krim nga urrejtja në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës dhe origjinës etnike

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Nxitja e urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës kombëtare, racore dhe fetare

Çka ndodhi: Më 7 qershor 2023, në media u publikuan lajme për grafitë ofenduese me kryqe naziste dhe mbishkrime “Gjupci”, të vizatuara me sprej të zi në shtëpitë e popullatës rome në rrugën Debarska në Manastir. Është një rast tjetër i krimit nga urrejtja, me një mesazh që bën thirrje për dhunë ndaj komunitetit etnik rom. Më 15 qershor në Manastir, Komiteti i Helsinkit u takua me një banor të rrugës Debarska, i cili na dha më shumë informacion për vetë ngjarjen, si dhe për faktin se kjo nuk është hera e parë që ka ndodhur ky lloj frikësimi dhe është penguar siguria e popullsisë rome atje. Njëpunësit policorë dolën në terren, por banorët nuk kanë informacion për veprime të mëtejshme. Një pjesë e grafitëve u pastruan nga vetë banorët, por pas dokumentimit të grafitëve të mbetura,

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut së bashku me një person në cilësinë e të dëmtuarit përgatitën kallzim penal në Prokurorinë Publike Manastir për kryerjen e veprës penale “Nxitje e urrejtjes, përçarjes ose intolerancës mbi baza kombëtare, racore, fetare dhe të tjera diskriminuuese” nga neni 319c “Rrezikimi i sigurisë” në lidhje me nenin 144 paragrafin 3 të Kodit penal. Ndërkohë, pak para paraqitjes së kallzimit penal, i dëmtuari është sulmuar fizikisht në të njëjtin vend ku është shkruar grafiti, me supozimin se sulmi është kryer nga të njëjtët autorë. Pas disa tentativave dhe këshillimeve ligjore, i dëmtuari ka vendosur të mos nisë procedurë penale.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, e racës dhe ngjyrës dhe treguesit e njëanshëm janë:

Origjina etnike – grafiti u drejtohet anëtarëve të komunitetit rom

Vendndodhja – grafiti u vizatua në një lagje ku jetojnë romët

Modeli i incidenteve të mëparshme – ngjarjet e mëparshme të frikësimit dhe rrezikimit të sigurisë së popullsisë rome në atë lagje

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave - /

Numri i kryerësve - /

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Dëmtimi i pronës, Shkaktimi i urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës kombëtare, racore dhe fetare

22. Krimi nga urrejtja në bazë të besimit fetar

[Incidente të kryera për shkak të përkatësisë fetare ose bindjes fetare](#)

[Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike](#)

[Nxitja e urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës kombëtare, racore dhe fetare](#)

Çka ndodhi: Në qershor, Komitetit të Helsinkit iu drejtua Goran Sadikario, drejtor i Muzeut të Holokaustit të Hebrejve në Maqedoni, i cili na informoi se grupi i tifozëve Ballistët nga Tetova kishte pikturuar grafitë me simbole naziste në disa vende të qytetit. Përveç kësaj, ai ndau me ne reagimet e komunitetit hebre ndaj ngjarjeve të mëparshme në Karnavalin në Strumicë, ku kishte një maskë me imazhin e Hitlerit, si dhe mbishkrime me kryqin nazist në gardhin e komunitetit hebre.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është bindja fetare, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Origjina etnike - grafitë që synojnë anëtarët e komunitetit hebre

Besimi fetar – grafitë që synojnë anëtarët e komunitetit hebre

Vendndodhja – një nga grafitet u vizatua në gardhin e komunitetit hebre

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme në shoqëri.

Numri i viktimave - /

Numri i kryerësve - /

Statusi i lëndës Nuk ka informacion

Lloji i incidentit Dëmtimi i pronës, Shkaktimi i urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës kombëtare, racore dhe fetare

23. Dëmtim i monumentit të mbrojtësit të vdekur në fshatin Indzhikovë

Incidente të kryera për shkak të përkatësisë etnike

Shkaktimi i urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës kombëtare, racore dhe fetare

Çka ndodhi: Më 02.08.2023 në SPB në Shkup, u raportua se në parkun në rrugën «8» në fshatin Inxhikovë, monumenti i mbrojtësit të ndjerë Goran Stojmenoviq u dëmtua me sprej. Një ekip nga NjPB Gazi Babë bëri këqyrje në vendin e ngjarjes dhe një prokuror publik u informua për ngjarjen.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Diferenca e supozuar në origjinën etnike

Vendndodhja – monument i mbrojtësit të ndjerë në fshatin Inxhikovë

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave -

Numri i kryerësve -

Statusi i lëndës -

Lloji i incidentit Shkatërrimi i simboleve

24. Incident në ndeshjen e futbollit në Gazi Babë

Incidente të kryera në garat sportive

Incidente të kryera për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Më 14.08.2023, një person nga Shkupi raportoi se gjatë shikimit të një ndeshje futbolli në një stadium futbolli në zonën e Gazi Babës, ai u sulmua fizikisht nga një person tjetër.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Origjina etnike – dallimi i supozuar në origjinën etnike ndërmjet viktimës dhe autorit

Vendndodhja – incidenti ka ndodhur në një ndeshje sportive

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave1

Numri i kryerësve - 1

Statusi i lëndës -

Lloji i incidentit Dhunë

25. Incident në bazë të përkatësisë etnike

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: më 8 shtator 2023, në SPB në Shkup, u raportua se para Poliklinikës Çair, ekipi mjekësor i urgjencës gjeti dy persona të plagosur me një objekt të mprehtë dhe të fortë, të cilët, sipas raportit, pas një mosmarrëveshjeje të ndërsjellë të mëparshme, u përleshën fizikisht. Personat u transferuan në Spitalin e Përgjithshëm të Qytetit “8 Shtatori” dhe Kompleksin e Klinikës “Nënë Tereza” për ndihmë mjekësore dhe më pas një prej personave u privua nga liria.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Përkatësia etnike – dallimi i supozuar në përkatësinë etnike ndërmjet personave

Mungesa e motiveve të tjera

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave1

Numri i kryerësve - 1

Statusi i lëndës -

Lloji i incidentit Lëndim trupor Dhunë

26. Sulmohet i mituri 17-vjeçar në Shkup

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Më 8 shtator 2023, në SPB në Shkup u raportua se një 17-vjeçar i plagosur nga Shkupi u soll në Spitalin e Përgjithshëm të Qytetit «Naum Ohridski». Sipas raportit, ai është sulmuar fizikisht në zonën e Çairit me një objekt të mprehtë nga një i mitur tjetër.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Përkatësia etnike – dallimi i supozuar në përkatësinë etnike ndërmjet viktimës dhe dhunuesit
Mungesa e motiveve të tjera

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave¹

Numri i kryerësve - 1

Statusi i lëndës -

Lloji i incidentit Lëndim trupor

27. Incident nga urrejtja në Shuto Orizari

Incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Më 11 shtator 2023, u raportua në SPB Shkup se në zonën e Shuto Orizarit, një i mitur u sulmua fizikisht nga një i mitur tjetër.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Përkatësia etnike – dallimi i supozuar në përkatësinë etnike ndërmjet viktimës dhe dhunuesit
Mungesa e motiveve të tjera

Modeli i incidenteve të mëparshme

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave¹

Numri i kryerësve - 1

Statusi i lëndës -

Lloji i incidentit Sulm fizik

28. Sulm fizik ndaj një shtetasi të Republikës së Turqisë

Incidentet e shkaktuara për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Më 15 shtator 2023, një shtetas i Republikës së Turqisë me banim në Shkup raportoi se ishte sulmuar fizikisht nga një person në zonën e Bit Pazarit.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Kombësia – viktima është shtetas i Republikës së Turqisë

Përkatësia etnike – dallimi i supozuar në përkatësinë etnike ndërmjet viktimës dhe dhunuesit
Mungesa e motiveve të tjera

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme në shoqëri.

Numri i viktimave -

Numri i kryerësve -

Statusi i lëndës –

Lloji i incidentit Sulm fizik

29. Incidenti nga urrejtja në bazë të besimit fetar dhe aftësisë së kufizuar

Veprime kundër personave me aftësi të kufizuara

Incidente të kryera për shkak të përkatësisë fetare ose bindjes fetare

Nxitja e urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës kombëtare, racore dhe fetare

Çka ndodhi: Në një vend parkimi të projektuar për personat me aftësi të kufizuara, pranë shkollës fillore “Gjorgjia Pulevski”, u vizatua një grafit me një simbol nazist – kryq i thyer .

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motive të njëanshme janë besimi fetar dhe aftësia e kufizuar, dhe tregues të njëanshëm janë:

Besimi fetar – grafiti me simbolin nazist u drejtohet anëtarëve të komunitetit hebre

Aftësi të kufizuara – Grafiti vizatohet në një hapësirë parkimi të projektuar për personat me aftësi të kufizuara

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme në shoqëri.

Numri i viktimave -

Numri i kryerësve -

Statusi i lëndës -

Lloji i incidentit - Shkatërrimi i pronës

Statusi i lëndës -

30. Krimi nga urrejtja në bazë të orientimit seksual

Incidente të kryera për shkak të orientimit seksual dhe/ose identitetit gjinor

Çfarë ndodhi: Punonjësit e qendrës social-kulturore «Komitet» raportuan se një shtetas i huaj i identifikuar si homoseksual u sulmua fizikisht nga një person i punësuar në “Giro Beko”. Ai pësoi lëndime të rënda trupore, por menjëherë pas raportimit ai u largua nga vendi. Nëpunësit policorë

nga SP Qendër menjëherë dolën në vendin e ngjarjes dhe kanë biseduar me autorët dhe dëshmitarët. Komiteti i Helsinkit ishte në takim me kryeshefin e Njësisë për Krim të Dhunshëm në Stacionin Policor Kisella Voda, i cili mori përsipër rastin dhe na informoi se ata do të paraqesin kallëzim penal ex officio për lëndime të rënda trupore. Me kërkesë të Komitetit të Helsinkit, incidenti u kualifikua si krim nga urrejtja, kryeshefi e la në dorë të prokurorit publik të vendosë.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është orientimi seksual, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Orientimi seksual – viktima identifikohet si homoseksual

Modeli i incidenteve të mëparshme – incidente të mëparshme mbi anëtarët e komunitetit LGBTI

Vendndodhja – incidenti ka ndodhur para qendrës social-kulturore “Komitet”

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme në shoqëri veçanërisht sigurinë e komunitetit LGBTI.

Numri i viktimave¹

Numri i kryerësve - 1

Statusi i lëndës -

Lloji i incidentit Sulm fizik me lëndim trupor

A keni raportuar në polici? Po

A jeni të kënaqur me qëndrimin e policisë? I/e kënaqur

Si reagoi policia? Ata menjëherë e regjistruan incidentin. Ata po hetojnë incidentin. Ata e kapën kryerësin.

31. Incident në ndeshjen e futbollit ndërmjet “Shkupit# dhe “Vardarit”

Incidente të kryera në gara sportive

Incidente të kryera për shkak të përkatësisë etnike

Çka ndodhi: Mediat raportuan se në ndeshjen e futbollit ndërmjet KF “Shkupi” dhe KF “Vardar” të zhvilluar më 05 nëntor 2023 në stadiumin në Çair, grupi i tifozëve të “Shkupit” – “Shvercerët” nxori parulla me mesazhe nacionaliste. “Do të përmbushim amanetin historik Shkupi të jetë zemra e Shqipërisë” ishte një nga parullat. Përveç kësaj, u dërgua mbështetje për vrasësit e anëtarit të Komitetë, Nikolla Sazdovski-Sazdo.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Përkatësia etnike – përkatësia etnike e ndryshme ndërmjet dy grupeve të tifozëve

Vendndodhja – incidenti ka ndodhur në një ndeshje sportive

Modeli i incidenteve të mëparshme – incidente të tilla kanë ndodhur më parë ndërmjet këtyre dy grupeve të tifozeve

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave -

Numri i kryerësve -

Statusi i lëndës –

Lloji i incidentit

32. Varri i dëmtuar në fshatin Paragushë

Incidente të kryera për shkak të përkatësisë etnike

Shkaktimi i urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës kombëtare, racore dhe fetare

Çka ndodhi: Më 22.11.2023 në orën 22.35 në SPB në Shkup, u raportua se në varrezat në fshatin Pagarushë, Shkup, disa persona dëmtuan një varr. Ndërmerren masa për zbardhjen e rastit.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Përkatësia etnike – dallimi i supozuar në përkatësinë etnike të kryerësit

Vendndodhja – varreza në fshatin Paragushë, që gjendet në Komunën e Studeniçanit ku jetojnë anëtarë të bashkësive të ndryshme etnike

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave -

Numri i kryerësve -

Statusi i lëndës -

Lloji i incidentit -Shkatërrimi i simboleve

33. Incident në një autobus ndërmjet të miturve

Incidente të kryera për shkak të përkatësisë etnike

Dhuna ndaj të miturve

Çka ndodhi: Një shofer autobusi në NPT raportoi se më 24 nëntor 2023, në zonën e Kisella Vodës në autobus pas një keqkuptimi të mëparshëm, kishte një prishje të rendit dhe qetësisë publike me një konfrontim fizik ndërmjet dy personave dhe tre të miturve të gjithë nga fshati Koliçan i Epërm-

rrethina e Shkupit nga njëra anë dhe nga ana tjetër një person dhe dy të mitur të gjithë nga fshati Koliçan i Poshtëm, rrethina e Shkupit.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Diferenca e supozuar në origjinën etnike

Modeli i incidenteve të mëparshme

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave -

Numri i kryerësve -

Statusi i lëndës -

Lloji i incidentit Dhunë

34. I mitur sulmohet në Shuto Orizar

Incidente të kryera për shkak të përkatësisë etnike

Dhuna ndaj të miturve

Çka ndodhi: Më 25.11.2023, një prind raportoi se në zonën e Shuto Orizarit, djali i tij u sulmua fizikisht nga katër të mitur dhe u përdor gjithashtu një objekt i fortë.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina etnike, dhe treguesit e njëanshëm janë:

Përkatësia etnike – dallimi i supozuar në përkatësinë etnike ndërmjet viktimës dhe dhunuesit

Mungesa e motiveve të tjera

Modeli i incidenteve të mëparshme

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

Numri i viktimave1

Numri i kryerësve 4

Statusi i lëndës -

Lloji i incidentit Sulm fizik

35. Incidenti nga urrejtja në bazë të besimit fetar

Incidente të kryera për shkak të përkatësisë fetare ose bindjes fetare

Nxitja e urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës kombëtare, racore dhe fetare

Çka ndodhi: Mediat raportuan se në oborrin e kompleksit të manastirit të “Shën Naumit të Ohrit” në Kodrën e Diellit, një person nga direku i vendosur në pronën e kishës hoqi flamurin e Kishës Ortodokse Maqedonase-OA, dhe më pas vendosi flamurin e Shqipërisë. Autori u arrestua brenda pak orësh nga nëpunësit policorë.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të njëanshëm: Në këtë incident, motive të njëanshme janë besimi fetar, dhe tregues të njëanshëm janë:

Besimi fetar – dallimi i supozuar në besimin fetar të dhunuesit

Vendndodhja – kompleksi i manastirit

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme në shoqëri.

Numri i viktimave -

Numri i kryerësve - 1

Statusi i lëndës Autorët e identifikuar

Lloji i incidentit Shkatërrimi i simboleve